

# STATUT

## I Shoqerise "MEDIA LIVING" sh.p.k.

Me cilesine e "ortakut themelues " :

Ervin VASO, i biri i Luit , i dtl. 25.06.1975, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet kartes se Identitetit Nr.034118736 me numer personal H50625152F, me vullnet të lire të plote e të sinqerte, mbeshtetur : Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", i ndryshuar ne ligjin " Per Qendren Kombetare te Biznesit ", ne ate ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor dhe Autoritetit perkates sipas objektit te shoqerise krijon Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi të Kufizuar, "MEDIA LIVING" sh.p.k. (me poshte e quajtur " Shoqeria " )

### KREUI

#### Neni 1

##### Krijimi

Shoqeria "MEDIA LIVING" sh.p.k., eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

#### Neni 2

##### Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "MEDIA LIVING" sh.p.k., është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Ortaku i Vetem, z. Ervin Vaso dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

#### Neni 3

##### Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, Shqiperi, me adrese : Rr."Fabrika e Qelqit", Zona Kadastrale Nr. 8230, Nr. Pas. 2/63, Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.

#### Neni 4

##### Objekti i veprimtarise

Veprimtari ekskluzive audio dhe/ose audiovizive. Ne funksion te veprimtarise ekskluzive audio dhe/ose audiovizive ushtron dhe veprimtari ne ndertimin e sistemeve te telekomunikacionit dhe transmetimeve audio dhe audiovizive dhe ripeseritjen e tyre ne cdo lloji transmetimi (satelitor, tokesor, kabllor, IPTV, OTT, Internet TV) ne forme te koduar apo te pakoduar, me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo meqdo mjet tjetet. Ne funksion te veprimtarise ekskluzive audio dhe/ose audio dhe audiovizive ushtron dhe veprimtari ne tregtimin e aparaturave per sistemet e transmetimit dhe marrjes se valeve audiovizive. Ne funksion te veprimtarise ekskluzive audio dhe/ose audiovizive ushtron dhe veprimtari ne ndertimin dhe shfrytezimin e rrjeteve numerike, per transmetimin satelitor, tokesor, kabllor IPTV, OTT, Internet TV me qellim ofrimin e sherbimit te transmetimit per publikun. Ne funksion te veprimtarise ekskluzive audio dhe/ose audiovizive ushtron dhe veprimtari ne prodhimin, transmetimin, ritransmetimin dhe shitjen ne menyre dixhitale te produkteve dhe sherbimeve audio e video. Ne funksion te veprimtarise ekskluzive dhe/ose audiovizive ushtron dhe veprimtari ne krijimin e nje rrjeti audioviziv me shtrirje ne shkalle kombetare si nepermjet mbulimit direkt te territorit te Republikes se Shqiperise ashtu edhe nepermjet mbeshtetjes ne median rajonale me shperndarje nepermjet valeve si dhe via kavo. Ne funksion te veprimtarise ekskluzive audio dhe/ose audiovizive ushtron dhe veprimtari ne prodhimin, tregtimin dhe shperndarjen e programeve te ndryshme audiovizive si dhe i video-audio kasetave ne formate te ndryshme, profesionale ose jo, bashkepunimin me rrjete televizive vendase dhe te huaja dhe perfaqesimin reciprok te tyre si dhe aktivite te tjera te lidhura ose plotesuese me ato te parat dhe cdo aktivitet tjetet te nevojshem ose te dobishem per ushtrimin e veprimtarise audiovizive. Ne funksion te veprimtarise ekskluzive audiovizive ushtron dhe veprimtari ne organizimin e aktiviteve artistike, muzikore, teatrale, kinematografike audio dhe/ose audiovizuale te cdo lloji ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj. Ne funksion te veprimtarise ekskluzive audio dhe/ose audiovizive ushtron dhe veprimtari ne organizimin e spektakleve, shfaqjeve teatrale, sfilatave te modes, botimeve te ndryshme, produksioneve, video dhe audio, perzgjedhjeve te vidioklipeve te ndryshme nepermjet konkurseve, perzgjedhjeve te modeleve mbarekombetare, shqipfolese. Ne funksion te veprimtarise ekskluzive audio dhe/ose audiovizive ushtron dhe veprimtari ne pjesemarrjen ne aktivite nderkombetare, qe lidhen me fushen e modes, modeleve e misseve, qe shpallen vetem nga aktiviteti i kesaj shoqerie, me qellim promovimin e vlerave te ndryshme te bukurise, kultures e historise shqiptare jashte vendit, duke u prezantuar ne keto te fundit, siç njihet vendi yne ne te tilla prezantime. Ne funksion te veprimtarise ekskluzive audio dhe/ose audiovizive ushtron dhe veprimtari ne prodhimin dhe shitjen e spektakleve televizive, shfaqjeve teatrale, shfaqjeve, dokumentareve, reklamave si dhe shperndarjen e tyre ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj. Ne funksion te veprimtarise ekskluzive audio dhe/ose audiovizive ushtron dhe veprimtari ne prodhimin dhe shperndarjen e filmave artistike te metrazhit te shkurter, te mesem dhe te gjate, te filmave vizatimore, filmave publicitare dhe te programeve audio-vizuale te cdo lloji, qe prodhohen ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj; Dublimin dhe subtitrimin e filmave te huajdhe te filmave shqiptare per vende te tjera. Ne funksion te

veprimtarise ekskluzive audio dhe/ose audiovizive ushtron dhe veprimtari ne prodhimin dhe tregtimin e botimeve te ndryshme, fletpalosjeve, shtypshkrimeve, qe pershtaten ketij objekti, agjensive turistike, hotelerive, moteleve, fshatrave turistike, si dhe agjensive per shitblerje, dhenie me qira te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, agjensive komisionere, etj. Zhvillimin dhe ndermjetesimin e projekteve per aktivitete te ndryshme te shoqerive me aktivitet artistik, muzikor, teatral, kinematografik audio dhe/ose audiovizual te cdo lloji ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj. Sigurimin e projekteve artistike, muzikore, teatrale, kinematografike dhe audio-vizuale dhe nenshkrimin e kontratave afatgjata per realizimin e ketyre projekteve. Ne funksion te veprimtarise ekskluzive audio dhe/ose audiovizive ushtron dhe veprimtari ne ndermjetesimin, nxjerrjen dhe perpunimin e materialeve artistike, muzikore, teatrale, kinematografike dhe audio-vizuale te te gjitha llojeve, veprimtari, sherbime, etj. Ne funksion te veprimtarise ekskluzive audio dhe/ose audiovizive ushtron dhe veprimtari ne kontaktimin me persona fizike dhe juridike, vendas ose te huaj, per gjetjen e tregjeve te blerjes dhe shitjes per prodhimet artistike te te gjitha llojeve, te shoqerise dhe shoqerive te tjera.

#### Neni 5

##### Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

#### KREU II

##### KAPITALI

#### Neni 6

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 lekë.

Kapitali i mesiperme eshte nenshkruar dhe shlyer tËrËsisht ne te holla nga "ortaku i vetem" i shoqerise :

z.Ervin Vaso, zoterues i 1 kuote, me vlere te pergjithshme 100.000 Leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

PjesËt e kapitalit themeltar nuk mund tË pËrfaqËsohen nga letra me vlerË tË tregtueshme.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te tretteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

#### Neni 7

##### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve tË pjesËve tË kapitalit themeltar pËr kontributet nË para dhe me anË tË kontributeve nË natyrË, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kËrkesËs sË administratorit.

ZvogËlimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem nË tË njËtat kushte qË kËrkohen pËr ndryshimin e statutit. Projekti i zvogËlimit tË kapitalit u komunikohet ekspertËve kontabËl tË autorizuar, nË rast se ka tË tillË, tË paktËn 45 ditË pËrpara datËs sË mbledhjes sË Ortakut te Vetem tË thirrur pËr tË marrË vendim rreth kËtij projekti.

ZvogËlimi i kapitalit themeltar nË njË vlerË mË tË vogËl se ajo e pËrcaktuar nË nenin 6

te këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mbledhet për të marrë vendim.

#### Neni 8

##### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombetare të Regjistrimit, sipas parashikimeve të ligjit 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### KREU II

##### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 9

##### Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.


Ortaku i Vetem është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.



Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 10

##### Administrimi

*Administrator i shoqërisë është z. Ervin Vaso, i emëruar në këto detyra për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërteritje.*

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetem të shoqërisë.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tij, njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

#### Neni 11

##### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetem edhe në rastet kur :

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim dhe

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i

administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin

këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### Neni 12

##### Përgjegjësia

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

#### Neni 13

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne

Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni14

##### Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### Neni 15

##### Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### Neni 16

Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem të shoqerise.

#### Neni 17

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetem.

Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

#### Neni 19

##### Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

#### Neni 20

##### Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

#### Neni 21

##### Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria



përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivitetet e pasivitetet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim të një shoqërie të re.

#### Neni 22

##### Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakut të Vetem, duke transferuar të gjitha aktivitetet e pasivitetet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 datë 14.04.2008.

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasojë për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

#### Neni 23

##### Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasojë mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

#### Neni 24

##### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këto statutet dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këto statutet, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 25

##### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të

treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.


Neni 26

Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi u miratua ne parim dhe nen per nen nga une Ortaku themelues i Shoqerise tregtare "MEDIA LIVING" sh.p.k., nenshkruhet nga une ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKU I VETEM**

Ervin VASO

Handwritten signature of Ervin Vaso in blue ink, consisting of the name 'Ervin Vaso' and a stylized flourish below it.

Date 02/03/2021